MOT' I PARƐ  1 ϬKURT 1909.  № 2.

# DITURIJA

E PƐRKOHƐϬME ϬQIP LITERARE БE DITURAKE

**DEL ИƐ HERƐ NƐ MUAJ**

*Dreqtoŋes*: Lumo Skendo

MBAN:

Tε vεmε re kur ϭkrojmε: Lumo Skεndo.— Fjalεtore e vogεlε.—Maj: M. G.—Pse bje tεrmeti —Jaho begu ðe Palok Cuca. — Ç' tε hamε, ç' tε pimε ðe qyϭ tε flemε. — Andej-Kεtej. — Pjesa ϭtεpiake. — Bibliografi.



SELANIK

ÇARϬI BAϬI, MYϬIR SOKAK.

# DITURIJA

## TƐ VƐMƐ RE KUR ϬKROJMƐ.

Dy qint e ϭtatε-ðet e kaqε vjet mê parε Frεngu i Barðε ðoϭ se, guha jonε po priϭet ðe po doçεtohetε. Kεtε zê munt tá nxjerim ðe ne sot.

Reguλat e ϭkroηεtores ðe tε sintaksit ϭqip, janε ϭum' mê tε hoλa ðe mê tε ðeλa nga ç' i pandehim ne. Kεto reguλa me ca vise tε Ϭqipεrisε popuλi i ka ruajturε tε fjeϭtta; po pεr ϭumε vεnde tε tjerε kεtε gε s' munt tá ðemi, ðe laðimet qε bεhen nga ηε herε janε ϭumε tε mbεðeη.

Pεr fat keq tani ϭohim se ðe n' atá vεnde ku guhεn' e kanε tε bukur ðe tε pastrε, dalεn ηerεs qε bεjnε laðime, ðe kjo duketε mê tepεrε kur ϭkrojnε. Laðimi nε tε folur s' εϭtε aq' i rezikϭim sa nε tε ϭkruarε: kεta laðime duke u-vεndosur nε ϭkrime, apin ηε ϭεmbελ tε ligε atyreve qε s' i kanε; eðe keϭtu ϭohim ηε gε tε veϭtirε: ϭkrimi nε vεnt qε tε na pastrojε ðe tε na fjeϭtεroje guhεn, po na nxjer nε ϭeϭ ðe na ϭton laðimet.

Ky rezik eϭtε gε pεr tε vεrejturε se bukuri e guhεs εϭtε fuqi ðe begati e ηε kombi.

Harimi nε tε cilεt kemi lεnε guhεn t' εnε gεr me sot, s' na ka qεn' aq' i dεmϭim pεr kεtε guhε, sa do tε jetε moskujdesj' e taniϭme pεr fjeϭtεsi ðe pastrεn' e saj. S' do haruarε qε laðimet e sotmε do tε na mbesin pεr giðeηε.

Barr' e keti faji u vjen atyreve qε ϭkruajnε pa marrε pakε mundim qε tε gykojnε reguλat ðe bukurin' e guhεsε. Mê tε ϭumεt e ϭkroηεset kujtojnε se s' kan' as ηε nevojε tε mejtojnε hoλεsit' e guhεs' sε tyre ðe pandehin se ηε guhε munt tε ϭkruhetε fare aϭtu si flitet nε qytet a nε pϭat tε tyre. Laðim, laðim i mað!

Ata qε duanε tε ϭkrojnε duhet qε tε pεrkujdesen tε vεrejnε mirε reguλat e vεrteta tε guhεs s'εnε: pεr kεtε gε sa ϭumε tε mundohenε, sa ϭumε tε rεmojnε ðe tε gykojnε mεsimet e ϭkroηεtoresε, prap' pak' εϭtε.

Kεtu duamε tε ϭεnojmε ca laðime qε hasen mê tεpεr nε ϭkrimet t' atyre qε nukε loðen tε vεnε re:

*Ηeriut mirε.* Na kεtu ηε laðim qε ϭohim ditε pεr ditε. *I mirε* εϭtε miemεr i nyjϭim, d-m-ð ka copεzεn *i* pεrpara: ðemi *ηeri i mirε*; pra ajo